



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:172076
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05570923

PA1.nr.1344/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Zyhdi Haziri - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarit K. R. , Gj, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par. 3 nënpar.3.2, lidhur me par 1 nënpar.1.4 , të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit K. R. - av. F. K. dhe ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit- të miturit E. Sh. - av. M. M: , të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.622/23, datë 07.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPP-ës, më datë 14.12.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit K. R. - av. F. K. dhe ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit- të miturit E. Sh. - av. M. M: , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.622/23, datë 07.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin, P.nr.622/23, datë 07.09.2023, të akuzuarin K. R. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par. 3 nënpar.3.2, lidhur me par 1 nënpar.1.4 , të KPRK-së së dhe e ka gjykuar me dënim me Dënim me burg në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas

plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Konform nenit 79 të KPRK-s, në dënimin e shqiptuar të akuzuarit i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 11.08.2023 e deri më datë 07.09.2023. Është obliguar i akuzuari që të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit në shumë prej 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm si dhe shpenzimet e procedurës penale për ekspertizë mjeko-ligjore shumë prej 20 (njëzetë) euro, dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20.00 € (njëzetë euro), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

Mbrojtësi i të akuzuarit K. R. - av. F. K. , për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale , vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal dhe shpenzimet e procedurës , duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesën të e aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar të e anuloi apo aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoi dhe të akuzuarit ti shqiptoi dënim me gjobë. ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptoj dënim më të lartë me gjobë.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit- të miturit E. Sh. - av. M. M: për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i lart.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.1378/23, të datës 26.10.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit- të miturit E. Sh. - av. M. M: , ndërsa , ndërsa të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit K. R. - av. F. K.. Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit- të miturit E. Sh. - av. M. M: mbeti në tersi pranë ankesës së ushtruar me shkrim me propozim që e njëjta të aprovohet si e bazuar , ndërsa për ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit propozoi që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së, caktoi seancën e kolegjit, për të cilën me kohë dhe në mënyrë të rregullt njoftoi palët. Në seancë ishin të ftuar, Prokurori i Apelit, i akuzuari K. R. , mbrojtësi i tije avokat F. K. i dëmtuari E. Sh. si dhe përfaqësuesi i autorizuar i tije avokat M. M: . Gjyqtari referues e referoi lëndën penale. Në seancë prezantuan të gjitha palët përpos Prokurorit të Apelit i cili edhe pse i ftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantoi në seancë. Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit- të miturit E. Sh. - av. M. M: mbeti në tersi pranë ankesës së ushtruar me shkrim me propozim që e njëjta të aprovohet si e bazuar , ndërsa për ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit propozoi që e njëjta të refuzohet si e pabazuar. I dëmtuari E. Sh. deklaroi se e mbështet në tersi ankesën e mbrojtësit të tije dhe të tej shton se me të akuzuarin nuk jemi pajtuar. Mbrojtësi i të akuzuarit K. R. - av. F. K. deklaroi se e mbështet në tersi ankesën e ushtruar me shkrim të njëjtën e elaboron dhe shton se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë dhe nuk i ka vlerësuar në mënyrë meritore rrethanat lehtësuese dhe atë faktin se i akuzuari qyshe në shqyrtimin fillestar në polici e e ka pranuar fajësinë, se është i gjendjes së varfër ekonomike dhe propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë.

I akuzuari K. R. e mbështet në tersi ankesën e ushtruar me shkrim nga ana e mbrojtësit të tij dhe propozon që ti zbutet dënimi.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- Ankesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 , nënpar.1.10 lidhur me 396 par 6 dhe 8 të KPP-ës , duke pretendua se aktgjykimi i ankimuar nuk ka arsye për çdo pikë.

Pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të akuzuarit janë të pabazuara, Aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë, në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar gjykata e shkallës së parë ka përshkruar sakët rrjedhën e procedurës, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, të cilat do e kishin e kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate edhe pse mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë e cekë këtë bazë ankimore , ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen faktike, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Mbrojtësi i të akuzuarit e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendimit mbi dënimin duke pretendua se që gjykata me rastin e peshimit të veprës penale dhe caktimit të dënimit nuk i marrë parasysh sjelljen korrekte të të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës , gjendjen e tij të varfër ekonomike , se është mbajtës i familjes si dhe nuk ka marrë parasysh as rrethanën posaçërisht lehtësuese se i dëmtuari nuk ka paraqitë kërkesës pasurore juridike si dhe mungesën e gjetjes së mjetit me të cilin është kryer vepra penale e të cilat rrethana po të ishin vlerësuar kishin me ndikuar në zbutjen e dënimit konform nenit 73 të KPRK-ës dhe po ti vlerësonte drejt rrethanat e lartcekura sidomos faktin se është i gjendjes së varfër ekonomike , se është mbajtës i vetëm i familjes të njëjtin do ta lironte edhe nga pagesa e shpenzimeve të procedurës konform nenit 449 par 2 nënpar.2.1 deri 2.9 të KPRK-ës. Nga të lartcekurat propozon ankesën të e aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar të e anuloi apo aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoi dhe të akuzuarit ti shqiptoi dënim me gjobë. ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptoj dënim më të lartë me gjobë.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit- të miturit E. Sh. - av. M. M: për shkak të vendimit mbi dënimin me pretendim që dënimi i dënimi i shqiptuar të akuzuarit nuk është adekuat me peshën e veprës penale , mënyrën e kryerjes dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, ketë e themi kur kemi parasysh faktin se i akuzuari gjatë periudhës kohore sa kanë udhëtuar me autobus në ditën kritike ka shprehë përgatitjen e tije për kryerjen e kësaj vepre penale duke i thënë tani të dëmtuarit shihemi kur të zbresim nga autobusi, me ç'rast në mënyrë tinëzore e sulmon të dëmtuarin dhe e godet duke i shkaktuar lëndime trupore si shihet nga raportet mjekësore , të gjitha këto tregojnë se i akuzuari ka qen i përgatitur psiqikisht mjaft lart për kryerjen e veprës penale. Tek i dëmtuari ka lënë shenja në fytyrën e tije që paraqet shëmtim, por edhe pasoja psiqike të një niveli mjaft të lart. Nga të gjitha këto propozon që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i lart.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit për shqiptimin e një dënimi më të butë-dënim me gjobë apo ato Përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit për shqiptimin e dënimit më të ashpër ndaj të akuzuarit, janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesat e lartcekura nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të ulët apo më të lartë, ndaj të akuzuarit. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit e duke u bazuar konform dispozitave 69,70,71 dhe 72 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, moshën e re, kërkim faljen dhe keqardhjen e shprehur për rastin e ndodhur, më parë nuk ka ra ndesh me ligjin dhe premtimin se në të ardhmen do të nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata merr parasysh, peshën dhe rrezikshmërinë e veprës penale, dashjen për kryerjen e kësaj vepre penale, shkallën e përgjegjësisë penale, mënyrën e kryerjes së veprës . Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë i shqiptoi të akuzuarit dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindjen se edhe me një dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit dhe ato rënduese në ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë apo që akuzuarit të i shqiptoj dënim më i butë apo më lartë , sikurse që pretendohet në ankesa, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të

akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutorë dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1344/23, më datë 14.12.2023

Zyrtarja ligjore;
Rrezarta Bala

Kryetari i kolegjit
Skender Çoçaj

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani

Zyhdi Haziri